



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova-Republic of Kosovo**  
**Qeveria - Vlada - Government**

*Ministria e Pushtetit Lokal*  
*Ministarstvo lokalne samouprave*  
*Ministry of Local Government*

---

Raport i situatës së pandemisë COVID - 19 për komunat e Republikës së Kosovës

Prishtinë, 2020

## Përmbajtja

Shkurtesat .....	3
Përmbledhje ekzekutive .....	4
Metodologjia .....	5
Veprimet e ndërmarra me rastin e pandemisë globale COVID - 19 .....	6
Ndikimi i vendimeve të qeverisë në komuna.....	9
Themelimi i shtabeve të emergjencave në komuna.....	9
Mbledhjet e kuvendeve të komunave dhe mjetet e ndara për menaxhimin e COVID - 19 .....	10
Planifikimi dhe realizimi i të hyrave vetanake në komuna.....	13
Të hyrat indirekte komunale .....	15
Buxheti dhe shpenzimet komunale .....	16
Shpenzimet krahasuar me buxhetimin sipas kategorive .....	18
Sfidat e komunave në kuadër të COVID - 19 .....	20
Referencat.....	21

## Shkurtesat

AKK	Asociacioni i Komunave të Kosovës
COVID 19	Pandemia e Coronavirusit
IKSHP	Instituti Kombëtar i Shëndetit Publike
KK	Kuvendi Komunal
MASHTI	Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit
MFT	Ministria e Financave dhe Transfere
MSH	Ministria e Shëndetësisë
MPB	Ministria e Punëve të Brendshme
MPL	Ministria e Pushtetit Lokal
QOE	Qendra Operative Emergjente
QOMPBP	Qendra Operative e Ministrisë së Punëve të Brendshme dhe Administratës Publike
QPKS	Qendra për Parandalim dhe Kontroll të Sëmundjeve
OBSH	Organizata Botërore e Shëndetësisë
ECDC	Qendra Evropiane për Parandalimin dhe Kontrollin e Sëmundjeve
SIMFK	Sistemi Informativ për Menaxhimin e Financave të Kosovës
SHE	Shtabet Emergjente
UNDP	Programi i Kombeve të Bashkuara për Zhvillim

## Përmbledhje ekzekutive

Ministria e Pushtetit Lokal konform mandatit dhe obligimeve ligjore që ka në raport me komuna, ka pasur një rol me rëndësi edhe në kuadër të pandemisë globale të COVID - 19, respektivisht në koordinimin e aktiviteteve në menaxhimin e saj. Në këtë segment, Ministria e Pushtetit Lokal me rastin e shfaqjes së pandemisë globale COVID – 19, ka qenë e orientuar kryesisht në koordinimin dhe bashkërendimin e aktiviteteve ndërmjet nivelit qendror dhe komunave. Gjatë kësaj periudhe, janë adresuar tek komunat një sërë kërkesash dhe njoftimesh tek kryetarët e komunave, kryesuesit e kuvendeve të komunave, Qendra Operative Emergjente (QOE), Qendra Operative e MPBAP (QOMPBPAP) dhe në Qendrën për Parandalim dhe Kontroll të Sëmundjeve (QPKS). MPL ka pasur një rol të rëndësishëm në koordinimin e aktiviteteve ndërmjet nivelit qendror dhe atij lokal. Janë zhvilluar vizita në komunat e prekura me COVID 19 dhe është ofruar përkrahje për të gjitha komunat, në mënyrë që ato të kenë më të lehtë menaxhimin e pandemisë në fjalë. Gjithashtu, janë mbajtur takime të përbashkëta me Ministrinë e Shëndetësisë, Kryetarët e Komunave, Asociacionin e Komunave Kosovës dhe shoqërinë civile për menaxhimin e COVID 19.

Me qëllim të zbatimit të vendimeve të qeverisë dhe ruajtjes së shëndetit publik në vend, 38 komuna kanë themeluar Shtabet e Emergjencave ku janë përfshirë të gjithë institucionet përgjegjëse dhe kanë ndihmuar në menaxhimin e situatës me COVID 19. Shtabet kanë mbajtur takime, prej tyre 7 komuna: Kamenicë, Mamushë, Podujevë, Novobërdë, Malishevë, Graçanicë, Shtërpcë kanë mbajtur gjithsej 102 takime, ndërsa komunat tjera kanë mbajtur në vazhdimësi takime të shtabeve emergjente. Me rastin e themelimit të shtabeve është respektuar dygjuhësia, ku komunat kanë ndryshuar dhe plotësuar vendimet e shtabeve emergjente pas kërkesës së qeverisë për t'i plotësuar vendimet edhe me anëtarë të pakicave që jetojnë në ato komuna. Gjatë pandemisë globale COVID-19, 31 komuna kanë mbajtur 51 mbledhje në kuvendet e komunave, ndërsa 7 komuna të tjera nuk kanë mbajtur asnjë takim, si: Leposaviq, Zubin Potok, Novobërdë, Zveçan, Graçanicë, Ranillug dhe Shtërpcë.

Sa i përket ndarjes së mjeteve për menaxhimin e pandemisë, nga 38 komuna gjithsej, 33 prej tyre kanë ndarë mjete financiare për menaxhimin e pandemisë së COVID – 19 në vlerë prej 4,771,008.74 euro. Komuna e cila më së shumti ka ndarë buxhet për menaxhim të COVID – 19 është komuna e Prishtinës me 1,380,000.00 euro, pastaj komuna e Fushë Kosovës me 404,000.00 euro, komuna e Podujevës me 366,520.00. Ndërsa, komunat të cilat nuk kanë ndarë mjete janë: Novobërdë, Pejë, Gjakovë, Istog dhe Klllokot.

Planifikimi i të hyrave vetanake në komunat e Republikës së Kosovës ka qenë në vlerë prej 83,116,579.00 €, kurse realizimi i tyre në periudhën Janar – Qershor është 26,961,729.00€ ose shprehur në përqindje 32.44%. Në bazë të përqindjes së inkasimit të të hyrave vetanake, komunat të cilat kanë nivelin e realizimit nga poshtë lartë, janë: komuna Zubin Potok 5.0% dhe Zveçan me 2.0%, komunat tjera kanë një nivel nën mesatar, ndërsa komuna e Graçanicës del se ka pasur rritje të të hyrave vetanake me një përqindje prej 78.0%.

Lidhur me buxhetimin dhe shpenzimet komunale, në këtë periudhë, komunat kanë planifikuar vlerën prej 582,542,659.42 € dhe i kanë shpenzuar buxhetet e tyre në vlerën e përgjithshme prej 180,361,788.03€ ose 31.0 % e buxhetit të planifikuar.

Sa i përket sfidave të komunave, komunat janë ballafaquar dhe akoma ballafaqohen me disa sfida dhe probleme të theksuara, si: varësia buxhetore nga niveli qendror, inkasimi i ulët i të hyrave vetanake, infrastruktura e dobët në sfondin e shëndetësisë, mungesa e pajisjeve higjienike, si dhe sfida të tjera.

## Metodologjia

Ky raport paraqet aktivitetet kryesore të Ministrisë së Pushtetit Lokal dhe komunave me rastin e shfaqjes së COVID – 19 dhe menaxhimin e saj. Për hartimin e këtij raporti janë konsultuar një sërë burimesh primare dhe sekondare, informatat janë marrë nga zyrtarët e MPL-së, zyrtarët komunal, si dhe nga Sistemi Informativ i Menaxhimit të Financave të Kosovës SIMFK, Departamenti i Thesarit - Ministria e Financave në periudhën Janar – Qershor 2020.

## Veprimet e ndërmarra me rastin e pandemisë globale COVID - 19

**M**inistria e Pushtetit Lokal në raport me komunat, me rastin e shfaqjes së pandemisë globale COVID – 19 ka qenë e orientuar kryesisht në koordinimin dhe bashkërendimin e aktiviteteve ndërmjet nivelit qendror dhe komunave. Gjatë kësaj periudhe, janë adresuar tek komunat një sërë kërkesash dhe njoftimesh tek kryetarët e komunave, kryesuesit e kuvendeve të komunave, Qendra Operative Emergjente (QOE), Qendra Operative e MPBAP (QOMPBPAP) dhe në Qendrën për Parandalim dhe Kontroll të Sëmundjeve (QPKS) me këto prioritete, si në vijim:

- ) Fillimisht është adresuar në Komuna, Plani i Gatishmërisë dhe Reagimit të Institucioneve për COVID-19, si dhe janë vënë në dispozicion pikat e kontaktit të MPL-së për komunat për adresimin e kërkesave të tyre. Menjëherë pas kësaj, është dërguar njoftimi tek kryetarët e komunave që deklarimet/informatat e tyre publike të jenë të kujdesshme dhe në harmoni të plotë me informatat zyrtare që dalin nga dy institucionet kryesore: Ministria e Shëndetësisë dhe Instituti Kombëtar i Shëndetësisë Publike të Kosovës;
- ) Komunat janë njoftuar me: Qarkoren për Informim të institucioneve Shëndetësore Publike dhe Private në Republikën e Kosovës Nr.05/2020, Letrën njoftuese për kryetarët e komunave për masat kundër COVID – 19, Vendimet e mbledhjeve të Qeverisë që kanë të bëjnë me situatën e pandemisë, sqarimet mbi zbatimin e Urdhëresës Nr.01/03 të datës 17.03.2020 (MEPTINIS) për zbatimin e masave ndaj veprimtarive ekonomike lidhur me emergjencën e shëndetit publik, Udhëzimet, Rekomandimet dhe PSO-të e Institutit Kombëtar të Shëndetit Publik të Kosovës, si dhe Vendimet përkatëse të Ministrisë së Shëndetësisë, Urdhëresën e MEPTINIS-së, Qarkoren ligjore të MPL-së, Udhëzues dhe akte të MPBAP-së;
- ) Janë siguruar informata, sipas kërkesës drejtuar komunave lidhur me nevojat për tenda të komunave, kërkesat specifike për të gjitha pajisjet, mjetet mbrojtëse dhe aparaturat, kërkesën për ngritjen e ekipeve mjekësore në zonat kufitare, kërkesën për sigurim të informatave dhe të dhënave të sakta lidhur me: a) numrin dhe kontaktet e personave të ardhur nga diaspora për secilën komunë veç e veç, si dhe b) emrin e vendbanimit, fshatit dhe lokacionit, pastaj kërkesën për mundësinë e përqendrimit të situatës në Kosovë për sa i përket përhapjes së Coronavirusit, kërkesa për funksionalizimin e Komiteteve Komunale për Mbrojtje dhe Shpëtim (*shtabet emergjente*) dhe dërgimit të kontakteve të personave përgjegjës të komunave, si dhe shkresën zyrtare në adresë të kryetarëve të komunave dhe kryesuesve të kuvendeve të komunave për “Themelimin dhe funksionalizimin e Komitetit Komunal për Reagim Emergjent (Shtabet Emergjente)”;
- ) Është adresuar kërkesa prioritare në emër të Qendrës Operative të Ministrisë së Punëve të Brendshme dhe Administratës Publike, me ç’ rast janë njoftuar komunat se Qendrat Operative dhe Komitetet Komunale për Mbrojtje dhe Shpëtim të komunave, duhet të jenë në kontakt të përhershëm me Qendrën Operative të MPBAP-së, 24/7, për informim, mbështetje, ndihmë dhe këshilla.

Gjithashtu, në këtë periudhë është adresuar Qarkorja ligjore Nr. 02, datë 23.03.2020 e MPL-së, janë mbledhur informata për pikat kontaktuese të shtabeve emergjente dhe vendimet për 38 komunat për themelimin e Shtabeve Emergjente. Është finalizuar lista e komunave: Malishevë, Deçan, Suharekë, Hani i Elezit, Mamushë, Viti, Istog, Gllogoc, Klinë, Obiliq, Podujevë dhe Skenderaj me numrin e të ardhurve nga Diaspora dhe të dhënat e tjera dhe e njëjta është përcjellë në Institutin Kombëtar të Shëndetësisë Publike të Kosovës, kurse në Ministrinë e Shëndetësisë janë adresuar kërkesat e komunave për tu pajisur me pajisje higjienike dhe mbrojtëse, si masë preventive në kuadër të menaxhimit të COVID -19. Më tej, janë përgatitur

dhe kompletuar të gjitha informatat e detajuara të komunave me shumicë serbe lidhur me gjendjen aktuale të përhapjes së pandemisë COVID – 19 dhe të njëjtat janë adresuar në Qendrën për Parandalim dhe Kontroll të Sëmundjeve, si dhe janë dërguar në baza ditore informatat e komunave: Leosaviq, Zveçan dhe Zubin Potok, në adresë të Qendrës për Parandalim dhe Kontrollë të Sëmundjeve lidhur me gjendjen aktuale të përhapjes së virusit.

Duke pas parasysh gjendjen e krijuar dhe vendosjen në karantinë të komunave, MPL ka njoftuar për pezullimin e përkohshëm të të gjitha shqyrtimeve të ligjshmërisë së akteve të organeve komunale. Lidhur me këtë, Ministria e MPL-së dhe kabineti i saj, menjëherë pas paraqitjes së rasteve të para, së bashku me Kryeministrin e Qeverisë së Republikës së Kosovës z. Kurtin dhe ministrinë përkatëse, kanë filluar vizitat në komunat ku u shfaq COVID-19, si: Klinë, Malishevë, Viti, Dragash, Fushë Kosovë, Rahovec, Prizren, Kamenicë, Gjilan, Pejë, Gjakovë, Lipjan, Viti, Ferizaj, Drenas, Skenderaj, Obiliq, Mamushë, Podujevë, Mitrovicë e Jugut, Istog, duke vazhduar edhe tek komunat tjera. MPL ka bërë njoftimin tek kryetarët e komunave dhe kryesuesit e kuvendeve të komunave lidhur me çështjen e adresimit në MFT, të vendimeve të Kuvendeve të Komunave për vlerësim të ligjshmërisë, përkatësisht vendimet të cilat ndërlihen me aspektet financiare, për të trajtuar çështjet që ndërlihen me situatën emergjente për parandalimin e COVID-19. Në të gjitha pikat e tjera, komunat janë udhëzuar që të zbatojnë Qarkoren Ligjore për Zbatimin e Vendimeve të Qeverisë për Parandalimin e Virusit COVID-19.

Me qëllim të ofrimit të shërbimeve për qytetarë, në këtë periudhë është funksionalizuar aplikimi on-line në ueb faqet e komunave, duke përfshirë Manualin e regjistrimit on-line për paraqitjen e kërkesës për certifikata të gjendjes civile dhe Manualin për përdorimin e Intranetit Komunal (*versioni shqip dhe serbisht*). Përmes MPL-së është dërguar në adresë të kryetarëve të komunave me shumicë serbe, shkresa zyrtare e MASHTI, lidhur me çështjen e organizimit dhe vazhdimin të procesit mësimor në shkollat në gjuhën serbe, si dhe kërkesa e komunës së Graçanicës lidhur me ardhjen e mjekëve nga Serbia. Kërkesa është aprovuar dhe mjekët kanë arritur në Graçanicë. Është adresuar kërkesa e Mitrovicës së Veriut lidhur me mundësinë e furnizimit me pajisje mbrojtëse dhe higjienike nga Depoja Qendrore e Ministrisë së Shëndetësisë, me fokus për Spitalin Rajonal të Mitrovicës së Veriut. Po ashtu, këto komuna janë njoftuar edhe me udhëzuesit e ECDC-së të cilat më parë janë pranuar nga Ministria e Shëndetësisë.

Në këtë periudhë është realizuar takim i përbashkët ndërmjet Ministrisë së Shëndetësisë, MPL-së dhe të gjithë kryetarëve të Komunave, me ç'rast kryetarët janë njoftuar lidhur me masat lehtësuese për menaxhimin e situatës emergjente për fazën e dytë dhe të tretë. Ndërkohë, MPL ka adresuar njoftimin tek kryetarët e komunave dhe kryesuesit e kuvendeve të komunave nga Qendra Operative e Ministrisë së Punëve të Brendshme dhe Administratës Publike për vendimin që lejet e veçanta për stafin esencial të komunave të Republikës së Kosovës t'i nxjerrin Shtabet përkatëse Emergjente të Komunave, për të cilat leja do të duhej të vlente vetëm për qarkullim brenda komunës përkatëse.

Gjatë kësaj periudhe, MPL ka dërguar në adresë të kryetarëve të komunave dhe kryesuesve të kuvendeve të komunave Anekset e vendimit për marrjen e masave kundër COVID 19, pastaj është adresuar kërkesa për dezinfektim të hapësirës së shkollës Qamil Batalli në Prishtinë në adresë të Qendrës Operative të MPBAP për shkak të fillimit të incizimit të videoshkollave nga ana e MASHTI, kërkesa prioritare e Qendrës Operative Emergjente në adresë të Komunës së Leosaviqit lidhur me transportimin e personit nga Qendra e Studentëve nga Karantina për në komunën e Leosaviqit, si dhe në baza ditore janë përcjellë informatat e komunave: Leosaviq, Zveçan dhe Zubin Potok në adresë të Qendrës për Parandalim dhe Kontrollë të Sëmundjeve lidhur me gjendjen aktuale të përhapjes së virusit Corona COVID – 19.

Në këtë periudhë, është dërguar në adresë të kryetarëve të komunave kërkesa prioritare e Qendrës Operative të MPBAP, për sigurimin e transportit të vullnetarëve, kërkesa për shtetasit e huaj (*shumica e tyre të nacionalitetit shqiptar nga Presheva Medvegja dhe Bujanovci*) të cilët nuk kanë leje të qëndrimit në Republikën e Kosovës dhe të njëjtit kanë nevojë për lëvizje të lirë në këtë kohë pandemie dhe kërkesa lidhur me dërgimin e raportit për veprimet e ndërmarra nga Drejtoritë e Inspektionit, për çështjen e shkeljeve që janë evidentuar dhe për masat që janë ndërmarrë ndaj bizneseve të cilat nuk i kanë zbatuar masat sipas Vendimit “*për parandalimin, luftimin dhe eliminimin e sëmundjes ngjithëse Covid-19*”. Po ashtu, është adresuar kërkesa e Ministrisë së Shëndetësisë tek kryetarët e komunave: Gllogoc, Ferizaj, Fushë Kosovë, Gjakovë, Gjilan, Istog, Obiliq, Prishtinë, Prizren, Shtime, Suharekë dhe Vushtrri lidhur me implementimin e masës 1.6 të Vendimit të Qeverisë Nr. 01/19 të datës 30.03.2020 dhe Vendimit të Ministrit të Financave dhe Transfereve Nr. 51/2020 të datës 12.05.2020. Pas kërkesës së pranuar nga Ministria e Financave dhe Transfereve, MPL ka adresuar njoftimin tek komunat me shumicë serbe lidhur me donacionin e ofruar nga UNDP për pajisje higjienike.

MPL ka mbajtur të informuar komunat për çdo vendim, kërkesë dhe njoftim të cilat kanë ardhur nga niveli qendror, si dhe ka pasur një rol koordinues me qëllim që kërkesat dhe prioritetet e komunave të adresohen tek niveli qendror. Po ashtu, është adresuar shkresa zyrtare tek Kryetarët e Komunave lidhur me menaxhimin e pandemisë COVID-19 dhe kërkesën lidhur me shtimin e kontroleve tek subjektet e gastronomisë dhe qendrave tregtare në luftimin e COVID 19. Në këtë periudhë janë dërguar në adresë të Qendrës Operative të MPBAP raportet e komunave lidhur me veprimet e ndërmarra nga Drejtoritë e Inspektionit, si dhe vendimet për 38 komunat e Kosovës për themelimin dhe funksionalizimin e Komiteteve Komunale Emergjente (Shtabeve Emergjente). Gjithashtu, është mbajtur takimi i përbashkët i forumit MPL - organizatat e shoqërisë civile për të diskutuar masat e ndërmarra nga MPL për komunat lidhur me COVID-19, plani kornizë i punës për vitin 2020 dhe planet e OJQ-ve për vitin 2020 në fushën e qeverisjes lokale.

#### Lista e Vendimeve të Qeveris dhe Ministrive të linjës që ndërlidhen me pandeminë COVID-19

- J *Vendim Nr.04/06 për miratimin e Planit për gatishmëri dhe reagim kundër Corona Virusit dhe Planin e veprimit, datë, 10.03.2020;*
- J *Vendim Nr. 01/07 për vendosjen e masave me qëllim të parandalimit të infeksionit Corona Virus COVID-19, datë, 11.03.2020 si dhe Vendimin Nr. 01/16 për ndryshimin dhe plotësimin e këtij vendimi;*
- J *Vendim Nr. 01/08 për themelimin e Komisionit të Posaçëm për parandalimin e infeksionit Corona Virus COVID-19, datë 12.03.2020;*
- J *Vendim Nr. 01/09 për marrjen e masave shtesë pas konfirmimit të rasteve pozitive me Corona Virus COVID-19, (vendosja në karantinë e komunave: Klinë dhe Viti), datë 13.03.202;*
- J *Vendim Nr. 01/10 për marrjen e masave shtesë pas konfirmimit të rasteve pozitive me Corona Virus COVID-19, (vendosja në karantinë e komunës së Malishevës, 14.03.2020;*
- J *Vendim Nr. 01/11 për shpalljen e emergjencës për shëndetin publik, datë 15.03.2020;*
- J *Vendimi i Ministrisë së Shëndetësisë Nr. 21/III/2020, datë 20.03.2020;*
- J *Urdhëresë e MEPTINIS Nr. ref.01/04 për mbarëvajtjen e veprimtarive ekonomike gjatë emergjencës së shëndetit publik, datë 20.03.2020;*
- J *Vendim Nr. 01/15 për ndërmarrjen e masave për parandalimin dhe kontrollin e përhapjes së virusit COVID-19, (ndalimi i qarkullimit të qytetarëve dhe automjeteve në kohë të caktuar, datë 23.03.2020;*
- J *Qarkore Informative e Ministrisë së Shëndetësisë Nr.11/2020 për informimin e Institucioneve Shëndetësore për zbatimin e Planit për rikthim në normalitet të shërbimeve shëndetësore;*
- J *Vendim i MAPL-së Nr. 02-269 për themelimin e Grupit Operativ në kuadër të ministrisë për parandalimin e infeksionit Corona Virus, COVID-19;*
- J *Vendim i MPBAP Nr. 162/2020 për pezullimin e trafikut urban, datë 31.03.2020;*
- J *Vendim i MSH Nr. 178/IV/2020 për shpalljen e Komunës së Prishtinës zonë karantinë, datë, 11.04.2020.*



## Ndikimi i vendimeve të qeverisë në komuna

Me rastin e përhapjes së pandemisë globale COVID – 19, MPL ka njoftuar komunat lidhur me vendimet e qeverisë dhe në bazë të informatave, të gjitha komunat kanë zbatuar vendimet nga Qeveria e Kosovës dhe masat e ndërmarra nga Ministria e Shëndetësisë. Po ashtu, me qëllim të zbatimit të këtyre vendimeve, kuvendet e komunave kanë mbajtur mbledhje të jashtëzakonshme duke respektuar masat e Ministrisë së Shëndetësisë për mbajtjen e distancës, si dhe të gjitha masat e parapara për ruajtjen e shëndetit publik. Në këto mbledhje kuvendet e komunave kanë miratuar vendimet për ndarjen e mjeteve financiare për përballimin e gjendjes së krijuar nga Pandemia Covid-19.

## Themelimi i shtabeve të emergjencave në komuna


Komunat e Republikës së Kosovës me qëllim të zbatimit të vendimeve të qeverisë dhe ruajtjes së shëndetit publik në vend, kanë themeluar Shtabet e emergjencave ku janë përfshirë të gjithë institucionet përgjegjëse dhe kanë ndihmuar në menaxhimin e situatës me COVID 19. Me rastin e themelimit të shtabeve është respektuar dygjuhësia, ku komunat kanë ndryshuar dhe plotësuar vendimet e shtabeve emergjente pas kërkesës së qeverisë për t'i plotësuar vendimet edhe me anëtarë të pakicave që jetojnë në ato komuna. Gjithashtu, dygjuhësia është respektuar edhe me rastet e hartimit të informatave dhe vendimeve të dala nga kuvendi i këtyre komunave apo shtabeve emergjente. Komunat të cilat kanë themeluar shtabet emergjente i kemi paraqitur në tabelën e mëposhtme, si vijon:

Nr.	Komunat	Numri i mbledhjeve të shtabit	Nr.	Komunat	Numri i mbledhjeve të shtabit
1.	Fushë Kosovë	Në vazhdimësi	20.	Obiliq	Në vazhdimësi
2.	Kaçanik	Në vazhdimësi	21.	Rahovec	Në vazhdimësi
3.	Mitrovicë e Jugut	Në vazhdimësi	22.	Pejë	Në vazhdimësi
4.	Shtime	Në vazhdimësi	23.	Klinë	Në vazhdimësi
5.	Hani i Elezit	Në vazhdimësi	24.	Istog	Në vazhdimësi
6.	Kamenicë	9 takime	25.	Lipjan	Në vazhdimësi
7.	Viti	Në vazhdimësi	26.	Graçanicë	20 takime
8.	Podujevë	9 takime	27.	Partesh	Në vazhdimësi
9.	Deçan	Në vazhdimësi	28.	Klllokot	Në vazhdimësi
10.	Prizren	Në vazhdimësi	29.	Ranillug	Në vazhdimësi
11.	Mamushë	9 takime	30.	Shtërpcë	12 takime
12.	Junik	Në vazhdimësi	31.	Prishtinë	Në vazhdimësi
13.	Mitrovicë e Veriut	Në vazhdimësi	32.	Gjakovë	Në vazhdimësi
14.	Leposaviq	Në vazhdimësi	33.	Glllogoc	Në vazhdimësi
15.	Zubin Potok	Në vazhdimësi	34.	Skenderaj	Në vazhdimësi
16.	Novobërdë	8 takime	35.	Suharekë	Në vazhdimësi
17.	Zveçan	Në vazhdimësi	36.	Ferizaj	Në vazhdimësi
18.	Vushtrri	Në vazhdimësi	37.	Dragash	Në vazhdimësi
19.	Malishevë	35 takime	38.	Gjilan	Në vazhdimësi

Tabela 1: Numri i mbledhjeve të mbajtura nga shtabet emergjente në komuna.

## Mbledhjet e kuvendeve të komunave dhe mjetet e ndara për menaxhimin e COVID - 19

Gjatë periudhës së pandemisë së COVID – 19 komunat kanë qenë mjaft aktive në mbajtjen e mbledhjeve të kuvendeve me çrast kanë ndarë edhe mjete financiare me qëllim të menaxhimit sa më efikas të pandemisë. Sipas të dhënave, komunat në këtë periudhë kanë mbajtur këto mbledhje, si vijon:



Diagrami 1: Numri i mbledhjeve të mbajtura nga kuvendet e komunave gjatë periudhës së COVID-19.


Siç mund të shohim nga diagrami, numrin më të madh të mbledhjeve të kuvendeve e kanë mbajtur komunat: Prizren dhe Gllgoc me gjithsej 3 takime, pastaj 19 komuna të tjera kanë mbajtur nga 2 takime/mbledhje si: Mitrovicë e Jugut, Shtime, Hani i Elezit, Kamenicë, Viti, Podujevë, Deçan, Vushtrri, Rahovec, Pejë, Klinë, Istog, Lipjan, Kllokot, Prishtinë, Skenderaj, Suharekë, Ferizaj dhe Dragash, 10 komuna kanë mbajtur nga 1 takim/mbledhje, si: Fushë Kosovë, Kaçanik, Mamushë, Junik, Mitrovicë Veriore, Malishevë, Obiliq, Partesh, Gjakovë dhe Gjilan. Ndërsa, 7 komuna të tjera nuk kanë mbajtur asnjë takim, si: Leposaviq, Zubin Potok, Novobërdë, Zveçan, Graçanicë, Ranillug dhe Shtërpcë. Gjatë kësaj periudhe, kuvendet e komunave kanë miratuar disa vendime të cilat kanë të bëjnë në përgjithësi me ndarjen e mjeteve financiare për menaxhimin e pandemisë COVID-19, siç i kemi pasqyruar në vijim përmes tabelës:

Komuna	Vendimet për ndarje te mjeteve buxhetit për menaxhim të COVID-19
Fushë Kosovë	- Vendim për ndarjen e mjeteve financiare për menaxhimin e COVID-19
Kaçanik	- Vendim për ndarjen e mjeteve financiare për menaxhimin e COVID-19
Mitrovicë e Jugut	- Vendim për ndarjen e mjeteve financiare për menaxhimin e COVID-19
Shtime	- Vendim për ndarjen e mjeteve financiare për menaxhimin e COVID-19
Hani i Elezit	- Vendim për ndarjen e mjeteve financiare për menaxhimin e COVID-19
Kamenicë	- Vendim për ndarjen e mjeteve financiare për menaxhimin e COVID-19
Viti	- Vendim për ndarjen e mjeteve financiare për menaxhimin e COVID-19
Podujevë	- Vendim për ndarjen e mjeteve financiare për menaxhimin e COVID-19
Deçan	- Vendim për ndarjen e mjeteve financiare për menaxhimin e COVID-19 - Vendim për ndarjen e mjeteve financiare në shumën prej 20,000.00 kompanisë N.SH. "Institute for Entrepreneurship and Small Business" për hartimin e raportit

	vlerësues mbi dëmet ekonomike të shkaktuara për prodhuesit dhe bizneset e komunës nga pandemia COVID-19
Prizren	- Vendim për ndarjen e mjeteve financiare për menaxhimin e COVID-19 - Vendim për bartjen e mjeteve të pa shpenzuara nga të hyrat vetanake të vitit 2018 dhe 2019 në vitin 2020, në programin shëndetësi dhe mirëqenie sociale, si dhe programin arsim dhe shkencë - Vendimin për lirimin nga pagesa e qirasë dhe taksave për bizneset që operojnë në pronën komunale në Komunën e Prizrenit për periudhën gjashtë (6) mujore (Mars-Gusht 2020) për shkak të situatës së pandemisë COVID-19
Mamushë	- Vendim për ndarjen e mjeteve financiare për menaxhimin e COVID-19
Junik	- Vendim për ndarjen e mjeteve financiare për menaxhimin e COVID-19
Mitrovicë e Veriut	- Vendim për ndarjen e mjeteve financiare për menaxhimin e COVID-19
Leposaviq	- Vendim për ndarjen e mjeteve financiare për menaxhimin e COVID-19
Zubin Potok	- Vendim për ndarjen e mjeteve financiare për menaxhimin e COVID-19
Zveçan	- Vendim për ndarjen e mjeteve financiare për menaxhimin e COVID-19
Vushtrri	- Vendim për ndarjen e mjeteve financiare për menaxhimin e COVID-19
Malishevë	- Vendim për ndarjen e mjeteve financiare për menaxhimin e COVID-19
Obiliq	- Vendim për ndarjen e mjeteve financiare për menaxhimin e COVID-19
Rahovec	- Vendim për ndarjen e mjeteve financiare për menaxhimin e COVID-19
Klina	- Vendim për ndarjen e mjeteve financiare për menaxhimin e COVID-19
Lipjan	- Vendim për ndarjen e mjeteve financiare për menaxhimin e COVID-19
Graçanicë	- Vendim për ndarjen e mjeteve financiare për menaxhimin e COVID-19
Partesh	- Vendim për ndarjen e mjeteve financiare për menaxhimin e COVID-19
Ranillug	- Vendim për ndarjen e mjeteve financiare për menaxhimin e COVID-19
Shtërpcë	- Vendim për ndarjen e mjeteve financiare për menaxhimin e COVID-19
Prishtinë	- Vendim për ndarjen e mjeteve financiare për menaxhimin e COVID-19
Gjakovë	- Vendim për bartjen e mjeteve të pa shpenzuara nga viti 2019 në buxhetin e vitit 2020
Glllogoc	- Vendim për ndarjen e mjeteve financiare për menaxhimin e COVID-19
Skenderaj	- Vendim për ndarjen e mjeteve financiare për menaxhimin e COVID-19
Suharekë	- Vendim për ndarjen e mjeteve financiare për menaxhimin e COVID-19
Ferizaj	- Vendim për ndarjen e mjeteve financiare për menaxhimin e COVID-19
Dragash	- Vendim për ndarjen e mjeteve financiare për menaxhimin e COVID-19
Gjilan	- Vendim për ndarjen e mjeteve financiare për menaxhimin e COVID-19

Tabela 2: Numri i vendimeve të kuvendeve të komunave.

Edhe pse disa komuna nuk kanë mbajtur mbledhje, ato megjithatë kanë ndarë mjete për menaxhimin e pandemisë. Në diagramin e mëposhtëm janë të pasqyruara komunat dhe shumat e ndara të mjeteve financiare për menaxhimin e pandemisë COVID-19, si vijon:



Diagrami 2: Shuma e mjeteve financiare të ndara nga komunat për menaxhimin e Pandemisë COVID-19.

Mund të shohim se nga 38 komuna sa janë gjithsej, 33 prej tyre kanë ndarë mjete financiare për menaxhimin e pandemisë së COVID – 19 në vlerë prej 4,771,008.74 euro. Komuna e cila më së shumti ka ndarë buxhet për menaxhim të COVID – 19 është komuna e Prishtinës me 1,380,000.00 euro, pastaj komuna e Fushë Kosovës me 404,000.00 euro, komuna e Podujevës me 366,520.00 e kështu me radhë.

## Planifikimi dhe realizimi i të hyrave vetanake në komuna

Ligji për Financat e Pushtetit Lokal përcakton se burimet e të hyrave komunale përveç garantëve qeveritar përbëhen edhe nga të hyrat vetanake, të cilat mbledhen nga komunat në emër të shërbimeve të ofruara për qytetarët. Të hyrat vetanake të komunave nga tatimet dhe taksat përbëjnë shtyllën kryesore prej së cilës varet qëndrueshmëria financiare e një komune, ato kontribuojnë në shtimin e buxhetit të një komune dhe si të tilla përbëjnë burim të rëndësishëm të të ardhurave komunale. Po ashtu, të hyrat komunale ndikojnë drejtpërdrejt në zhvillimin ekonomik të komunave të Republikës së Kosovës. Bazuar në të dhënat zyrtare të Sistemit Informativ të Menaxhimit të Financave të Kosovës SIMFK, Departamenti i Thesarit - Ministria e Financave, në vitin 2020 planifikimi i të hyrave vetanake të komunave është në vlerë prej 83,116,579.00 €, ndërsa në vitin 2019 ky planifikim ka qenë 84,894,883.00€. Nga kjo shihet së ka ulje në planifikimin e të hyrave vetanake në vitin 2020 në krahasim me vitin 2019, në vlerë prej 1,778,304.00 €, ose për (2.1 %) me pak. Sa i përket realizimit të të hyrave vetanake, nga të dhënat zyrtare nga Sistemi Informativ i Menaxhimit të Financave të Kosovës SIMFK, Departamenti i Thesarit - Ministria e Financave, gjatë periudhës janar - qershor 2020, komunat kanë realizuar të hyra vetanake në shumën prej 26,961,729.00 € të hyra vetanake, ose 32.44% nga niveli i planifikuar vjetor prej 83,116,579.00 €. Në periudhën janar - qershor 2019, realizimi i të hyrave vetanake nga komunat ka qenë prej 35,732,308.00 € ose 42.09% sipas planifikimit vjetor prej 84,894,883.00€, ndërsa në vitin 2020, në këtë periudhë janë realizuar 26,961,729.00 €, ose 24.05 %, sipas planifikimit vjetor prej 83,116,579.00 €. Në vijim përmes tabelës në aspektin krahasimor kemi paraqitur realizimin e të hyrave vetanake në periudhën Janar – Qershor 2019 dhe 2020:

Realizimi i të hyrave vetanake për periudhën Janar - Qershor 2019 krahasuar me periudhën Janar – Qershor 2020							
Viti 2019			Viti 2020			Krahasimet	
Planifikimi	Realizimi	% e realizimit	Planifikimi	Realizimi	% e realizimit	Krahasimi i planifikimit 2019/2020 i shprehur në %	Krahasimi i realizimit 2019/2020 i shprehur në %
84,894,883	35,732,308	42.09	83,116,579	26,961,729	32.44	-2.1	-9.7

Tabela 3: Realizimi i të hyrave dhe krahasimi për periudhën janar - qershor 2019 - 2020.

Pra, siç shihet edhe në tabelën e paraqitur, në periudhën Janar – Qershor 2020, realizimi i të hyrave vetanake sipas planifikimit vjetor të komunave është 32.44%, ndërsa në periudhën Janar - Qershor 2019 ka qenë 42.09%. Nga kjo shihet se ka rënie në planifikimin e të hyrave për 2.1% në vitin 2020. Po ashtu, vërehet se ka rënie në realizimin e të hyrave prej, 9.7% në vitin 2020 krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit 2019.


Në vijim përmes tabelës kemi paraqitur të dhënat lidhur me planifikimin dhe realizimin e të hyrave vetanake për periudhën janar-qershor 2020 krahasuar me periudhën janar-qershor 2019, sipas Komunave:

**PLANIFIKIMI DHE REALIZIMI I TË HYRAVE VETANAKE PËR PERIUDHËN JANAR - QERSHOR 2020 KRAHASUAR ME PERIUDHËN JANAR - QERSHOR 2019**

Komunat	Viti 2019			Viti 2020			Krahasimet		
	Planifikimi	Realizimi	% e realizimit 2019	Planifikimi	Realizimi	% e realizimit 2020	Krahasimi i planifikimit 2019/2020 i shprehur në %	Krahasimi i realizimit 2019/2020 i shprehur në %	Krahasimi i % së realizimit 2019/2020
Gllgoc	1,209,360	486,817	40.25	1,390,790	388,370	27.92	-15.0	-20.2	-12.3
Fushë Kosovë	2,822,814	1,208,646	42.82	2,809,510	1,018,392	36.25	-0.5	-15.7	-6.6
Lipjan	2,108,547	855,541	40.57	2,080,919	482,364	23.18	-1.3	-43.6	-17.4
Obiliq	908,804	597,353	65.73	1,022,665	415,889	40.67	12.5	-30.4	-25.1
Podujevë	1,614,600	575,942	35.67	1,416,561	401,657	28.35	-12.3	-30.3	-7.3
Prishtinë	30,656,113	13,306,737	43.41	29,258,367	10,231,754	34.97	-4.6	-23.1	-8.4
Shtime	451,114	201,937	44.76	629,651	124,441	19.76	39.6	-38.4	-25.0
Graçanicë	1,713,956	694,535	40.52	1,787,166	1,393,479	77.97	4.3	100.6	37.4
Dragash	477,510	133,283	27.91	462,344	79,910	17.28	-3.2	-40.0	-10.6
Prizren	8,418,404	3,176,429	37.73	7,560,295	2,452,862	32.44	-10.2	-22.8	-5.3
Rahovec	1,710,394	537,459	31.42	1,156,841	390,250	33.73	-32.4	-27.4	2.3
Suharekë	1,934,756	836,491	43.23	1,970,656	617,866	31.35	1.9	-26.1	-11.9
Malishevë	849,790	401,648	47.26	896,091	256,003	28.57	5.4	-36.3	-18.7
Mamushë	71,717	32,644	45.52	63,197	14,147	22.39	-11.9	-56.7	-23.1
Deçan	720,973	198,228	27.49	770,266	208,409	27.06	6.8	5.1	-0.4
Gjakovë	3,554,081	1,554,544	43.74	3,722,367	1,140,174	30.63	4.7	-26.7	-13.1
Istog	1,224,119	533,281	43.56	1,151,298	303,844	26.39	-5.9	-43.0	-17.2
Klinë	1,065,552	402,399	37.76	915,074	317,585	34.71	-14.1	-21.1	-3.1
Pejë	4,215,027	1,792,459	42.53	4,349,595	1,726,636	39.70	3.2	-3.7	-2.8
Junik	102,631	61,142	59.57	137,199	47,206	34.41	33.7	-22.8	-25.2
Leposaviq	23,843	768	3.22	40,000	544	1.36	67.8	-29.2	-1.9
Mitrovicë	2,534,831	1,274,740	50.29	2,499,975	736,502	29.46	-1.4	-42.2	-20.8
Skenderaj	968,124	331,285	34.22	1,528,014	211,872	13.87	57.8	-36.0	-20.4
Vushtrri	2,358,613	956,176	40.54	2,035,660	755,539	37.12	-13.7	-21.0	-3.4
Zubin Potok	10,177	899	8.83	30,000	611	2.04	194.8	-32.1	-6.8
Zveçan	16,151	364	2.25	35,000	1,751	5.00	116.7	380.9	2.7
Mitrovicë Veriore	38,445	20,798	54.10	60,000	14,184	23.64	56.1	-31.8	-30.5
Gjilan	4,462,871	1,805,964	40.47	4,399,396	1,067,385	24.26	-1.4	-40.9	-16.2
Kaçanik	720,339	275,723	38.28	710,727	249,354	35.08	-1.3	-9.6	-3.2
Kamenicë	899,181	379,739	42.23	862,074	241,845	28.05	-4.1	-36.3	-14.2
Novobërdë	247,038	80,876	32.74	242,479	63,714	26.28	-1.8	-21.2	-6.5
Shtërpcë	314,322	166,669	53.03	489,205	93,262	19.06	55.6	-44.0	-34.0
Ferizaj	4,719,802	2,143,911	45.42	5,015,526	1,098,500	21.90	6.3	-48.8	-23.5
Viti	1,085,310	440,166	40.56	948,599	213,266	22.48	-12.6	-51.5	-18.1
Partesh	58,466	26,954	46.10	63,801	33,071	51.83	9.1	22.7	5.7
Hani i Elezit	314,704	159,234	50.60	317,865	119,880	37.71	1.0	-24.7	-12.9
Kllokot	136,270	44,195	32.43	158,842	30,396	19.14	16.6	-31.2	-13.3
Ranillug	156,134	36,329	23.27	128,564	18,816	14.64	-17.7	-48.2	-8.6
<b>Totali</b>	<b>84,894,883</b>	<b>35,732,308</b>	<b>42.09</b>	<b>83,116,579</b>	<b>26,961,729</b>	<b>32.44</b>	<b>-2.1</b>	<b>-24.5</b>	<b>-9.7</b>

Tabela 4: Realizimi i të hyrave dhe krahasimi për periudhën, janar - qershor 2019 me periudhën, janar – qershor 2020.

Ndërsa, sa i përket participimit dhe llojit të të hyrave vetanake të komunave, në këtë periudhë dhe krahasimi me periudhën e njëjtë të vitit 2019, kemi këto të dhëna, si vijon:



Diagrami 3: Të hyrat sipas kategorive të të hyrave vetanake.

Nga ky diagram, mund të shohim se pjesëmarrja më e lartë në kuadër të të hyrave vetanake në komuna ka qenë: tatimi në pronë, ndërsa më niveli më i ulët është shënuar në kategorinë e regjistrimit të trashëgimisë. Më qëllim që të shihet ndikimi negativ që ka pasur COVID-19 në realizimin e të hyrave vetanake, në vijim përmes tabelës kemi paraqitur të dhënat lidhur me realizimin e të hyrave sipas strukturës për periudhën Janar-Qershor 2020 dhe krahasimi me periudhën e njëjtë 2019 gjatë kësaj periudhe.

### Të hyrat indirekte komunale

Komunat përveç mbledhjes së të hyrave direkte të cilat janë aktivitet i drejtpërdrejt i komunave, pranojnë edhe të hyrat indirekte të cilat mbledhen nga niveli qendror si: dënimet në gjykata, gjobat nga policia dhe të hyrat e licencave nga agjencioni i pyjeve, të cilat transferohen në komuna. Këto të hyra nuk planifikohen nga komunat por vetëm pranojnë dhe bëhet pjesë e buxhetit të komunave të cilat mund t'i shpenzojnë sipas prioriteteve të komunës.

Realizimi i të hyrave indirekte për periudhën Janar–Qershor 2020 janë 3,406,568.24 ndërsa në periudhën e njëjtë të viti paraprak të cilat ishin në shumën prej 5,353,176.00 shprehur në % është (36.36%) më pak në vitin 2020 se sa në vitin 2019. Në vijim janë paraqitur detajet e mbledhjes së të hyrave indirekte sipas komunave dhe llojit të të hyrave indirekte.

Komunat	Të hyrat indirekte të komunave Janar-Qershor 2019				Të hyrat indirekte të komunave Janar-Qershor 2020				Krahاسimet 2020/2019			
	Të hyrat nga gjobat e policisë	Të hyrat nga gjokat e gjykatave	Të hyrat nga licencat për pyje	Totali i të hyrave indirekte 2019	Të hyrat nga gjobat e policisë	Të hyrat nga gjokat e gjykatave	Të hyrat nga licencat për pyje	Totali i të hyrave indirekte 2020	Krahاسimet 2020/2019 -Të hyrat nga gjobat e policisë	Krahاسimet 2020/2019 -Të hyrat nga gjokat e gjykatave	Krahاسimet 2020/2019 -Të hyrat nga licencat për pyje	Krahاسimet 2020/2019 -Totali i të hyrave indirekte
Totali	4,878,830.00	453,102.87	21,243.13	5,353,176.00	3,209,636.50	193,085.00	3,846.74	3,406,568.24	(34.21)	(57.39)	(81.89)	(36.36)

Tabela 5: Raporti i të hyrave indirekte të komunave Janar - Qershor 2019 dhe Janar – Qershor 2020.

## Buxheti dhe shpenzimet komunale

Buxheti dhe shpenzimet komunale janë ndër çështjet me substanciale të komunave, sepse apriori ato ndërlihen edhe me mënyrën e menaxhimit të parasë publike. Bazuar në të dhënat zyrtare nga Sistemi Informativ për Menaxhimin e Financave të Kosovës (SIMFK) - Departamenti i Thesarit - Ministria e Financave, komunat e Republikës së Kosovës për periudhën raportuese janar-qershor 2019 kanë shpenzuar buxhetet e tyre në vlerë të përgjithshme prej 236,595,273.96 € ose 41 % e buxhetit të planifikuar në vlerë prej 572,265,198.84 €, kurse për vitin 2020 për periudhën Janar-Qershor 2020 kanë shpenzuar 180,361,788.03 € ose 31 % nga buxheti i planifikuar prej 582,542,659.42 €. (Shih tabelën në vijim):

Pasqyra e shpenzimeve komunale për periudhën Janar - Qershor 2020 dhe krahasimi me periudhën Janar - Qershor 2019								
Kategoritë ekonomike	Viti 2020			Viti 2019			Krahاسimi i realizimit të shpenzimeve 2020-2019	
	Buxheti 2020	Shpenzimet et 2020	% e realizimit 2020	Buxheti 2019	Shpenzimet et 2019	% e realizimit 2019		
Totali i shpenzimeve	582,542,659.42	180,361,788.03	31.0	572,265,198.84	236,595,273.96	41.0	(10.0)	
Rrogat dhe pagat	274,689,354.56	113,497,375.40	41.3	273,069,487.76	131,621,033.05	48.0	(6.7)	
Mallrat dhe shërbime	81,592,626.21	29,550,401.30	36.2	68,573,655.41	32,026,480.25	47.0	(10.8)	
Shpenzimet komunale	11,776,939.88	4,331,860.11	36.8	11,951,517.65	6,099,130.36	51.0	(14.2)	
Subvencione dhe transfere	17,653,381.56	3,394,266.30	19.2	21,139,837.85	12,624,269.20	60.0	(40.8)	
Shpenzimet kapitale	196,830,357.21	29,587,884.92	15.0	197,530,700.17	54,224,361.10	27.0	(12.0)	

Tabela 6: Shpenzimet komunale, janar – qershor 2020 dhe krahasimi me periudhën, Janar – Qershor 2019.



Nga tabela e mësipërme, shihet se ka rënie të shpenzimeve në të gjitha kategoritë ekonomike, për përdhën Janar- Qershor 2020, krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit paraprak. Në vijim kemi pasqyruar shpenzimet e komunave për periudhën Janar- Qershor 2020 krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit 2019, sipas komunave:

Pasqyra e shpenzimeve komunale për periudhën Janar - Qershor 2020 dhe krahasimi me periudhën Janar- Qershor 2019							
Komunat	Viti 2020			Viti 2019			Krahasimi i realizimit të shpenzimeve
	Buxheti	Shpenzimet	% e realizimit	Buxheti	Shpenzimet	% e realizimit	
Glllogoc	16,511,851.6	4,371,767.2	26.5	15,827,014.3	6,041,447.4	38.0	(11.5)
Fushë Kosovë	14,409,297.3	3,990,472.1	27.7	13,540,009.9	7,378,202.4	54.0	(26.3)
Lipjan	17,473,385.3	5,249,848.3	30.0	16,715,481.4	6,695,083.4	40.0	(10.0)
Obiliq	11,840,344.4	2,573,004.8	21.7	12,814,608.6	3,828,893.0	30.0	(8.3)
Podujevë	23,304,529.4	6,833,100.4	29.3	22,476,239.3	8,455,696.9	38.0	(8.7)
Prishtinë	116,053,914.6	27,261,237.8	23.5	110,591,713.2	38,648,752.4	35.0	(11.5)
Shtime	7,611,309.5	2,335,773.7	30.7	7,345,156.8	2,983,118.7	41.0	(10.3)
Graçanicë	7,845,736.5	2,639,701.7	33.6	8,044,223.5	3,875,807.3	48.0	(14.4)
Dragash	9,197,800.6	2,607,504.0	28.3	9,053,223.8	3,013,976.6	33.0	(4.7)
Prizren	51,760,320.9	15,002,578.0	29.0	49,851,747.7	19,159,367.8	38.0	(9.0)
Rahovec	14,020,947.9	6,023,825.1	43.0	14,994,840.4	7,673,250.7	51.0	(8.0)
Suharekë	16,511,168.6	5,022,860.1	30.4	16,614,172.8	7,103,164.9	43.0	(12.6)
Malishevë	14,597,223.2	5,478,790.2	37.5	14,231,423.6	6,712,032.9	47.0	(9.5)
Mamushë	1,941,121.1	608,052.6	31.3	2,120,188.9	678,534.6	32.0	(0.7)
Deçan	9,291,250.2	3,577,896.3	38.5	9,188,963.7	4,303,602.6	47.0	(8.5)
Gjakovë	26,256,511.1	9,039,343.5	34.4	26,351,258.6	12,189,909.5	46.0	(11.6)
Istog	11,426,233.6	3,266,991.3	28.6	11,287,247.5	3,933,314.4	35.0	(6.4)
Klinë	10,584,103.6	3,452,281.2	32.6	10,307,526.5	4,503,469.9	44.0	(11.4)
Pejë	27,784,865.2	10,568,121.8	38.0	27,047,522.3	13,435,416.8	50.0	(12.0)
Juniku	1,703,282.4	672,624.6	39.5	1,857,774.9	686,390.5	37.0	2.5
Leposaviq	4,756,856.5	1,132,212.6	23.8	4,675,381.1	2,467,023.7	53.0	(29.2)
Mitrovicë	20,828,029.1	7,572,678.6	36.4	19,976,601.4	10,162,251.5	51.0	(14.6)
Skenderaj	14,592,890.8	4,768,190.1	32.7	14,064,164.4	6,065,745.6	43.0	(10.3)
Vushtrri	20,134,909.3	6,965,204.4	34.6	19,938,425.0	7,221,202.0	36.0	(1.4)
Zubin Potok	2,560,814.9	613,416.9	24.0	2,606,272.0	792,705.2	30.0	(6.0)
Zveçan	2,443,622.3	583,412.7	23.9	2,510,813.6	670,046.4	27.0	(3.1)
Mitrovica Veriore	6,360,359.7	1,664,717.2	26.2	6,075,981.3	3,217,226.8	53.0	(26.8)
Gjilan	26,563,135.8	10,186,239.4	38.3	26,420,324.0	11,806,415.1	45.0	(6.7)
Kaçanik	8,361,486.0	2,902,637.3	34.7	8,567,326.8	3,376,212.8	39.0	(4.3)
Kamenicë	9,332,700.1	3,431,038.8	36.8	9,723,291.9	4,156,083.2	43.0	(6.2)
Novobërdë	2,772,988.0	969,098.9	34.9	2,827,233.3	1,134,057.5	40.0	(5.1)
Shtërpcë	4,118,935.0	1,170,517.6	28.4	4,022,461.8	1,429,743.1	36.0	(7.6)
Ferizaj	31,271,640.6	11,157,127.9	35.7	31,580,263.6	16,851,530.5	53.0	(17.3)
Viti	11,353,868.0	4,262,870.7	37.5	11,392,547.3	5,369,575.3	47.0	(9.5)
Partesh	1,263,854.0	514,525.7	40.7	1,291,437.8	593,158.2	46.0	(5.3)

Hani i Elezit	2,659,200.1	937,017.6	35.2	3,082,872.4	1,071,306.7	35.0	0.2
Kllokot	1,103,745.0	404,834.2	36.7	1,257,040.9	619,392.8	49.0	(12.3)
Ranillug	1,938,427.2	550,273.3	28.4	1,992,422.8	639,721.0	32.0	(3.6)
GIITHSEJ	582,542,659.4	180,361,788.0	31.0	572,265,198.8	236,595,274.0	41.0	(10.0)

Tabela 7: Pasqyra e shpenzimeve komunale për periudhën Janar - Qershor 2020 dhe krahasimi me periudhën Janar-Qershor 2019, sipas komunave.


### Shpenzimet krahasuar me buxhetimin sipas kategorive

Bazuar në të dhënat zyrtare nga Sistemi Informativ për Menaxhimin e Financave të Kosovës (SIMFK) Departamenti i Thesarit - Ministria e Financave, komunat e Republikës së Kosovës për periudhën Janar – Qershor 2020 kanë planifikuar vlerën prej 582,542,659.42 € dhe i kanë shpenzuar buxhetet e tyre në vlerën e përgjithshme prej 180,361,788.03 € ose 31 % e buxhetit të planifikuar. Krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit 2019, vërejmë se në vitin 2019, komunat kanë shpenzuar 41% ose 10% më shumë së këtë vit. Buxheti i komunave të Republikës së Kosovës sipas kategorive ekonomike në përgjithësi dhe krahasimi me vitin paraprak 2019, është si vijon:

- J) Kategoria rroga dhe paga - Në vitin 2020 kategoria e rrogave dhe pagave është planifikuar në vlerë prej 274,689,354.56 €, kurse është shpenzuar në vlerë prej 113,497,375.40 € ose 41 %. Ndërsa në vitin 2019, kategoria e rrogave dhe pagave është planifikuar në vlerë prej 273,069,487.76 €, ndërsa gjatë kësaj periudhe është shpenzuar në vlerë prej 131,621,033.05 €, ose 48%. Nga kjo vërejmë së ka një rënie të shpenzimeve në këtë kategori prej 7%. Krahasuar me planifikimin kjo kategori në 34 komuna është shpenzuar prej 40%-50%, kurse nënë 40% është në 4 komuna, (Zubin Potok, Zveçan dhe Mitrovicë e Veriut me 33%, dhe Leposaviqi 39%).
- J) Kategoria Mallra dhe Shërbime - është planifikuar në vlerë prej 81,592,626.21 € ndërsa është shpenzuar në shumë prej 29,550,401.30 € ose 36.2. Ndërsa në vitin 2019, kjo kategori është planifikuar në vlerë prej 68,573,655.41 €, ndërsa gjatë kësaj periudhe është shpenzuar në vlerë prej 32,026,480.25 €, ose 47%. Nga kjo vërejmë së ka një rënie të shpenzimeve në këtë kategori prej 10.8%. Krahasuar me planifikimin në këtë kategori, Mamusha e ka përqindjen më të ulët të realizimit prej 18%, kurse komunat me përqindje më të lartë të realizimit janë: Komuna e Mitrovicës së Veriut me 49%, Komuna e Graçanicës me 45%, si dhe Peja, Lipjani, Malisheva nga 44%.
- J) Kategoria Shpenzime Komunale - kjo kategori ka pasur shumën e planifikuar prej 11,776,939.88 € dhe sipas të dhënave janë shpenzuar 4,331,860.11 € ose 36.8 %. Ndërsa në vitin 2019, kjo kategori është planifikuar në vlerë prej 11,951,517.65 €, ndërsa gjatë kësaj periudhe është shpenzuar në vlerë prej 6,099,130.36 €, ose 51 %. Nga kjo vërejmë së ka një rënie të shpenzimeve në këtë kategori prej 14.2%. Komuna e Mitrovicës Veriore ka realizimin e shpenzimeve më të ulëtën me vetëm 4%, po ashtu një përqindje të ulët e ka edhe komuna e Zveçanit me vetëm 6%, si dhe 3 komuna janë me realizim të buxhetit me 50 % (Malishevë, Viti dhe Mamushë).
